



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING			
Njësisë Org. Org. Jedinica Org. Unit	M-01	Nr. Prot. Broj. Proje. Prot. No.	2167/26
Nr. ifaqeve Broj. stranica No. pages	03	Datimi Datum Date	27.04.2026
PRISHTINE/A			

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Ministrja e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 93, paragrafit 4 të Kushtetutës së Kosovës, në përputhje me nenin 11, nënparagrafi 1.5 i Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 34/2022), të nenit 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/2019), nenit 17, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i Rregullores Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, nenit 12, 15 dhe dispozitave tjera të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 23/2023), nenit 8, 9 dhe nenit 110, paragrafi 3 dhe 6 të Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2013), Rishikimin e Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023–2027 dhe Planin e Veprimit 2023–2025, Udhëzimin Administrativ MMPH-Nr. 05/2016 për Rregullimin e Statusit të Pasurisë Ujore, si dhe dispozitave tjera ligjore të ligjit në fuqi, nxjerr këtë:

V E N D I M
Për Ndalimin e Transferimit të Tokave Ujore

1. Ndalohet reptësisht çdo lloj veprimi i zyrtarëve publikë në nivel qendror dhe komunal me qëllim të çfarëdo transferimi pronësor të tokës ujore pa zbatimin e dispozitave referuese të Ligjit për Ujërat e Kosovës 2013 dhe Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr. 05/2016 për Rregullimin e Statusit të Pasurisë Ujore.
2. Ndërprerja e statusit të pasurisë ujore publike natyrale e artificiale (tokave ujore) është e lejuar vetëm në përputhje me Nenin 12 të UA MMPH-Nr. 05/2016 për Rregullimin e Statusit të Pasurisë Ujore (lex specialis), ku ndërprerja e statusit të tokave ujore përcaktohet vetëm me Vendim të Ministrisë përgjegjëse për menaxhim të resurseve ujore dhe Vendim të Qeverisë së Kosovës.
3. Obligohet Inspektorati Qendror i Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore (ARPL), Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) dhe Zyrat Kadastrale Komunale (ZKK), komunat, si dhe institucionet tjera përkatëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimet apo kontratat e lidhura në kundërshtim me përcaktimet e dispozitave të këtij vendimi janë nule.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Ministria, sipas detyrës zyrtare, njoftimeve nga Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit dhe palëve tjera tematike, ka konstatuar se aktivitete të caktuara të transferimit pronësor të tokave ujore janë në zhvillim ose janë zhvilluar nga subjekte të caktuara institucionale dhe persona fizikë në kundërshtim të plotë me legjislacionin specifik të ujërave, i cili është lex specialis i çështjes tematike.

Ky vendim është në harmoni me veprimet III/7 dhe III/8 të Planit të Veprimit 2023–2025 për Rishikimin e Strategjisë Shtetërore për Ujëra, ku përfshihet edhe "ndalimi i ndërtimeve dhe aktiviteteve të ndaluara" (faqe 59, Rishikimi i Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023-2027 dhe Plani i Veprimit 2023-2025).

Vendimi për ta ndaluar transferimin e tokës ujore bazohet në rregullativën ligjore që përcakton se: "Pasuria ujore është pasuri me interes të veçantë për Republikën e Kosovës" (Neni 4, paragrafi 5 i UA MMPH Nr. 05/2016 për Rregullimin e Statusit të Pasurisë Ujore), ku si e tillë konsiderohet e mirë e përgjithshme në pronësi të shtetit, gjë që përjashton atë nga transferimi juridiko-pronësor. Ligji i Ujërave përcakton që toka ujore nuk mund të tjetërsohet, shitet ose transferohet në pronë private.

Mosndërmarrja e këtij vendimi do të sillte pasoja të konsiderueshme:

- Degradim i ekosistemeve ujore për shkak të ndërtimeve dhe ndërhyrjeve të pakontrolluara;
- Rritje e rrezikut nga përmbytjet si rezultat i ngushtimit të shtretërve të lumenjve;
- Humbje e pasurisë publike përmes privatizimit të paligjshëm ose të dyshimtë;
- Kosto të larta rehabilitimi për buxhetin shtetëror;
- Konflikte ligjore dhe pronësore që rëndojnë sistemin gjyqësor.

Vendimi për ndalimin e transferimeve është:

- I ligjshëm, pasi bazohet në kompetencat e ministrisë përkatëse sipas ligjeve në fuqi;
- I nevojshëm, për shkak të rreziqeve reale dhe të dokumentuara;
- Proporcional, pasi nuk ndalon përdorimin racional të pasurive ujore, por vetëm tjetërsimin e tyre.

Ky vendim nuk çënon të drejtat e ligjshme të palëve, por vendos kufizime të arsyeshme në funksion të interesit publik.

Pika 1 e dispozitivit të vendimit është në përputhje me Nenin 8, 9 dhe 110 të Ligjit për Ujërat e Kosovës 2013.

Pika 2 e dispozitivit të vendimit është në përputhje me Nenin 12 të UA MMPH për Rregullimin e Statusit të Pasurisë Ujore.

Sipas Nenit 12 të UA MMPH përcakton se:

1. Një tokë e humb statusin e pasurisë ujore publike nëse:
 - 1.1. Me vendim të Ministrit, përmes të cilit konstatohet se ajo tokë nuk është më e nevojshme për destinimet e përcaktuara sipas nenit 9 të këtij Udhëzimi Administrativ.
 - 1.2. Me vendim të Qeverisë së Kosovës përcaktohet që ajo pasuri ujore publike të shfrytëzohet për interesa të tjerë të përgjithshëm.

Pika 3 e dispozitivit të vendimit është në përputhje me kompetencat institucionale tematike të strukturave organizative institucionale.

Pika 4 e dispozitivit të vendimit është në përputhje me Nenin 15.5 të Ligjit Nr. 08/L-125 Për Pronën Publike.

Pika 5 e dispozitivit të vendimit është në përputhje me nenin 51 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Kabinetit të Ministres të MMPH-se;
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-se;
- Agjencionit Kadastral të Kosovës(AKK)
- Inspektorati i Ministrisë ;
- ARPL;
- Divizionit për Komunikim Publik;
- Të gjitha komunave



Fitore Pacolli Dalipi:

Ministre e Ministrisë së Mjedisit dhe
Planifikimit Hapësinor